



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DEVOLL, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË”, ZJ. ESMERALDA ENVER MEDOLLI

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me shkresën nr. 3182 prot., datë 08.10.2024, Këshilli i Bashkisë Devoll ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Genti Sotir Lakollari, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 12, zj. Esmeralda Enver Medolli.

Me shkresën nr. 2969, prot., datë 14.10.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Devoll, zj. Esmeralda Enver Medolli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KO-PS-23606_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Esmeralda Enver Medolli, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr.3088 prot., datë 28.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3087 prot., datë 28.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Esmeralda Enver Medolli.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 11811/1 prot., datë 6.11.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Esmeralda Enver Medolli, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.17078/1 prot., datë 1.11.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Esmeralda Enver Medolli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Esmeralda Enver Medolli, në këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Licela VELIU - Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ - Drejtoria e Ligjshmërisë (në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)